



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 65

Tiranë – E martë, 16 prill 2024

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 22/2024, datë 21.3.2024	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 21.2.2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, ‘Për buxhetin e vitit 2024’”.....	7691
Dekret i Presidentit nr. 141, datë 12.4.2024	Për shpallje ligji.....	7691
Ligj nr. 26/2024, datë 21.3.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33/2021, “Për gardën e Republikës së Shqipërisë”	7691
Dekret i Presidentit nr. 140, datë 11.4.2024	Për shpallje ligji.....	7692
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 141, datë 29.2.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 139/1, datë 7.4.2017, “Për substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore”.....	7692
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 267, datë 8.4.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Suedisë	7694
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 268, datë 8.4.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	7696
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 269, datë 8.4.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë.....	7697
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 270, datë 8.4.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	7698

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 7.3.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1893 (300), datë 13.9.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.....	7699
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 27.3.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arçova”.....	7713
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 27.3.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	7714
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 27.3.2024	Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	7715
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 27.3.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Protergia Energy Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike	7717
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 27.3.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ensco Trading (Albania)” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	7718
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 27.3.2024	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 361, datë 7.12.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gealb Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet ‘Guri i Bardhë 1’ dhe ‘Guri i Bardhë 2’”.....	7719
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 27.3.2024	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 31.5.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SGD Energji’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Ndërfushas’, me kapacitet të instaluar 1125 kw”.....	7721

**LIGJ**
Nr. 22/2024**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË
21.2.2024, “PËR DISA NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 97/2023, ‘PËR BUXHETIN E
VITIT 2024’”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 21.2.2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, ‘Për buxhetin e vitit 2024’”.

Miraturar në datën 21.3.2024.

Shpallur me dekreten nr. 141, datë 12.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 141, datë 12.4.2024**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 22/2024, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 21.2.2024, ‘Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, ‘Për buxhetin e vitit 2024’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 26/2024**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 33/2021, “PËR GARDËN
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pika 4 e nenit 13 ndryshohet si më poshtë:

“4. Personalitetet e tjera, pas përfundimit të detyrës, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes personale kur u rrezikohet jeta ose shëndeti për shkak të detyrës që kanë kryer. Rregullat, procedura dhe kohëzgjatja e mbrojtjes personale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Pika 3 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

“3. Personalitetet e tjera, pas përfundimit të detyrës, gëzojnë të drejtën për ruajtjen dhe mbrojtjen e banesës kur u rrezikohet jeta ose shëndeti i tyre, ose i familjes së tyre për shkak të detyrës që kanë kryer. Rregullat, procedura dhe kohëzgjatja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së banesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në nenin 17 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Ministri i propozon Kryeministrit kandidatin për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës pas kryerjes së një procesi të konkurrimit të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e kandi-



datit për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Drejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës mund të emërohet shtetasi shqiptar që në kohën e kandidimit përmbush këto kushte:

- a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën;
- d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë në fushën e rendit ose sigurisë;
- dh) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e rendit ose sigurisë;
- e) të mos jetë larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;
- ë) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- f) të mos ketë marrë cilësinë e të pandehurit për kryerjen e një vepre penale, ose ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë e sigurimit personal;
- g) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.”.

Neni 4

Në nenin 59 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. E drejta e trajtimit me veshje civile për punonjësit e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përfitohet nëpërmjet kompensimit në vlerë monetare, në masën dhe sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të ministrit.”.

Neni 5

Në nenin 68, paragrafi i parë numërohet me numrin “1” dhe pas paragrafit të parë shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Koha e qëndrimit në gradat e fituara sipas ligjit nr. 9366, datë 31.3.2005, “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”,

sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, për efekt të ecurisë në gradë, konsiderohet si kohë e qëndrimit në gradën e njësuar, sipas këtij ligji”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.3.2024.

Shpallur me dekretin nr. 140, datë 14.4.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 140, datë 11.4.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 26/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 33/2021, ‘Për Gardën e Republikës së Shqipërisë’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR

Nr. 141, datë 29.2.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN NR. 139/1, DATË 7.4.2017,
“PËR SUBSTANCAT AKTIVE
FARMAKOLOGJIKE DHE
KLASIFIKIMIN E TYRE NË LIDHJE ME
KUFIJTË MAKSIMALË TË MBETJEVE
NË PRODUKTET USHQIMORE ME
ORIGINË SHTAZORE”^{1, 2, 3, 4}**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 81, të ligjit nr. 10465,

¹ Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2023/2203, e datës 20 tetor 2023, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 37/2010, në lidhje me klasifikimin e substancës *Rafloxanide*, në lidhje me kufirin maksimal të mbetjeve të saj në produktet ushqimore me origjinë shtazore.

² Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2023/454, e datës 2 mars 2023, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 37/2010, në lidhje me klasifikimin e substancës *Toltrazuril*, në lidhje me kufirin maksimal të mbetjeve të saj në produktet ushqimore me origjinë shtazore.

³ Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2023/981, e datës 17 maj 2023, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 37/2010, në lidhje me klasifikimin e substancës *Praziquantel*, në lidhje me kufirin maksimal të mbetjeve të saj në produktet ushqimore me origjinë shtazore.

⁴ Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2023/2194, e datës 19 tetor 2023, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 37/2010, në lidhje me klasifikimin e substancës *Ketoprofen*, në lidhje me kufirin maksimal të mbetjeve të saj në produktet ushqimore me origjinë shtazore.



datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në tabelën 1, “substancat e lejuara”, të shtojcës “Substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimi i

tyre sipas maksimumit të lejuar të mbetjeve (LMM)”, bashkëlidhur urdhrin nr. 139/1, datë 7.4.2017, “Për substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre, në lidhje me kufijtë maksimalë të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore”, bëhen disa shtesa dhe ndryshime, si vijon:

SHTOJCË SUBSTANCAT AKTIVE FARMAKOLOGJIKE DHE KLASIFIKIMI I TYRE SIPAS MAKSIMUMIT TË LEJUAR TË MBETJEVE (LMM)

Tabela 1. Substancat e lejuara

Substanca aktive farmakologjike	Lloji i mbetjeve	Lloji i kafshës	LMM	Lloji i indeve	Dispozita të tjera në përputhje (me nenin 6, pika 7, të urdhrin 363, datë 3.1.2013)	Klasifikimi terapeutik
Ketoprofen	Nuk aplikohet	Gjedhë,	Nuk kërkohet LMM	Nuk aplikohet	Nuk përfshihet	Nuk përfshihet
		Derr,				
		Kuaj				
	Ketoprofen	Shpend	10 µg/kg	Muskul	Nuk përdoret në kafshët, vezët e të cilave prodhohen për konsum njerëzor	Nuk përfshihet
			30 µg/kg	Lëkurë dhe dhjam në proporcion natyral		
			10 µg/kg	Mëlçi		
			10 µg/kg	Veshkë		
Praziquantel	Nuk aplikohet	Në të gjithë ripërtypësit përveç gjedhit, kuajve	Nuk kërkohet LMM	Nuk aplikohet	Nuk përfshihet	Nuk përfshihet
	Praziquantel (shuma e izomerëve)	Fin fish	20 µg/kg	Muskul dhe lëkurë në proporcion natyral	Nuk përfshihet	Nuk përfshihet
Rafoxanide	Rafoxanide	Në të gjithë ripërtypësit përveç dhenve	30 µg/kg	Muskul	Nuk përfshihet	Agjentë antiparazitarë/ Agjentët (që veprojnë) kundër endoparazitëve
			30 µg/kg	Dhjam		
			10 µg/kg	Mëlçi		
			40 µg/kg	Veshkë		
			10 µg/kg	Qumësht		
		Dhen	100 µg/kg	Muskul	Nuk përfshihet	
			250 µg/kg	Dhjam		
			150 µg/kg	Mëlçi		
			150 µg/kg	Veshkë		
			10 µg/kg	Qumësht		
Toltrazuril	Toltrazuril sulfone	Në të gjitha llojet e gjitarëve që prodhojnë ushqim	100 µg/kg	Muskul	Për speciet e derrit, LMM e dhjamt lidhet me “lëkurën dhe dhjamtin në proporcion natyral”. Nuk përdoret në kafshët, qumështi i të cilëve prodhohet për konsum njerëzor.	Agjentë antiparazitarë/ agjentë që veprojnë kundër protozoarëve
			150 µg/kg	Dhjam		
			500 µg/kg	Mëlçi		
			250 µg/kg	Veshkë		
		Shpendë	100 µg/kg	Muskul	Nuk përfshihet	
			200 µg/kg	Lëkurë dhe dhjam		
			600 µg/kg	Mëlçi		
			400 µg/kg	Veshkë		
			140 µg/kg	Vezë		



2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 267, datë 8.4.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SUEDISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve e kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Fagersta*		
Norberg*		
Kirovohrad	Dolyn's'kyi*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, Faqe| 7694

mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Suedisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të



OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqrave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt

ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të nenin 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të



derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 568, datë 29.9.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Suedisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 268, datë 8.4.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,
Faqe | 7696

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht,

nga shteti i Italisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	*Ndarja administrative e nivelit të tretë
1	Lombardia	Brescia	Isorella
2	Lombardia	Brescia	Pavone Del Mella
3	Lombardia	Brescia	Gottolengo
4	Lombardia	Brescia	Milzano
5	Lombardia	Brescia	Pralboino
6	Lombardia	Brescia	Gambara
7	Lombardia	Brescia	Remedello
8	Lombardia	Brescia	Calvisano
9	Lombardia	Brescia	Pozzolengo
10	Lombardia	Brescia	Cigole
11	Lombardia	Como	Sorico
12	Lombardia	Cremona	Casalmorano
13	Lombardia	Cremona	Grontardo
14	Lombardia	Mantua	Roverbella
15	Lombardia	Mantua	Medole
16	Lombardia	Mantua	Asola
17	Lombardia	Mantua	Goito
18	Lombardia	Mantua	Ceresara
19	Lombardia	Mantua	Volta Mantovana
20	Lombardia	Mantua	Guidizzolo
21	Lombardia	Mantua	Pegognaga
22	Lombardia	Mantua	Acquanegra Sul Chiese
23	Lombardia	Mantua	Piubega
24	Lombardia	Pavia	Arena Po
25	Piemonte	Cuneo	Pianfei
26	Sardegna	Cagliari	Cagliari
27	Toscana	Florence	Scandicci
28	Toscana	Florence	Campi Bisenzio
29	Toscana	Prato	Vernio
30	Toscana	Prato	Montemurlo
31	Veneto	Padua	Lozzo Atestino
32	Veneto	Padua	Santa Margherita d' Adige
33	Veneto	Padua	Ponso
34	Veneto	Padua	Ospedaletto Euganeo
35	Veneto	Padua	Vighizzolo d' Este
36	Veneto	Padua	Casale Di Scodosia
37	Veneto	Padua	Saletto
38	Veneto	Padua	Sant' Urbano
39	Veneto	Padua	Piove Di Sacco
40	Veneto	Rovigo	San Bellino
41	Veneto	Verona	Casaleone
42	Veneto	Verona	Isola Della Scala
43	Veneto	Verona	San Bonifacio
44	Veneto	Verona	Verona
45	Veneto	Verona	San Giovanni Lupatoto
46	Veneto	Verona	Erbè
47	Veneto	Verona	Buttapietra
48	Veneto	Verona	Salizole
49	Veneto	Verona	Bovolone



50	Veneto	Verona	Zimella
51	Veneto	Verona	Pescantina
52	Veneto	Verona	Cologna Veneta
53	Veneto	Verona	Veronella
54	Veneto	Verona	Roverchiara
55	Veneto	Verona	Bonavigo
56	Veneto	Verona	Pressana
57	Veneto	Verona	Isola Rizza
58	Veneto	Verona	Cerea
59	Veneto	Verona	Terrazzo
60	Veneto	Verona	Albaredo d' Adige
61	Veneto	Verona	Cazzano Di Tramigna
62	Veneto	Verona	Illasi
63	Veneto	Verona	Oppeano
64	Veneto	Verona	Trevenzuolo
65	Veneto	Verona	Minerbe
66	Veneto	Vicenza	Villaga
67	Veneto	Vicenza	Noventa Vicentina
68	Veneto	Vicenza	Montegald
69	Veneto	Vicenza	Castegnero
70	Veneto	Vicenza	Albettone
71	Veneto	Vicenza	Sossano
72	Veneto	Vicenza	Orgiano
73	Veneto	Vicenza	Campiglia Dei Berici
74	Veneto	Vicenza	Longare
75	Veneto	Vicenza	Camisano Vicentino
76	Veneto	Vicenza	Pojana Maggiore
77	Emilia-Romagna	Bologna	Crevalcore
78	Apulia	Lecce	Lecce

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 159, datë 4.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 269, datë 8.4.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SUEDISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Suedisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	*Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
1	Sjöbo*		
2	Ystad*		
3	Svedala*		

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit



biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 91, datë 13.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 270, datë 8.4.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Adana	Kozan*	
Adana	Aladag*	
Malatya	Arguvan*	

Karaman	Merkez*	
Izmir	Dikili*	
Kars	Kağızman*	
Hakkari	Merkez*	
Aydin	Sultanhisar*	
Çankiri	Çerkeş*	
Ankara	Bala*	
Ankara	Polatlı*	
Afyon	Sandıklı*	
Aksaray	Merkez*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve gjalla të llojit të dhirta dhe të leshta, materialit biologjik, dhe nënprodukteve të kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, nga ndarjet administrative të shtetit të Turqisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.3:

2.1 Për kafshët e llojit të dhirta dhe të leshta certifikata veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja, ose për 21 ditë e fundit, në një stabiliment ku nuk është raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve ose dhive gjatë asaj periudhe, dhe se stabilimenti nuk ka qenë i vendosur në një zonë të infektuar me linë e dhenve ose të dhive; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine për 21 ditë para dërgesës;

ç) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

d) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përkrahura në manualin tokësor jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 4 muaj përpara dërgesës (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virusi i gjallë, i çaktivizuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshirë në vaksinë duhet të shënohen në certifikatë).

2.2 Për spermën e cjepeve dhe deshve, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se kafshët dhuruese:

a) nuk shfaqin asnjë shenjë klinike të lisë së dhenve ose dhive në ditën e mbledhjes së spermës dhe për 21 ditët në vijim;

b) janë mbajtur në vendin eksportues për 21 ditë para grumbullimit, në një stabiliment ose qendër fekondimi artificial ku nuk janë raportuar zyrtarisht asnjë rast i lisë së dhenve dhe dhive gjatë asaj



periudhe, dhe se stabilimenti ose qendra e mbarështimit artificial nuk është e vendosur në zonën e infektuar të lisë së dhenve dhe dhive;

c) nuk janë vaksinuar kundër lisë së dhenve dhe dhive; ose

ç) janë vaksinuar duke përdorur një vaksinë që përputhet me standardet e përshkruara në manualin tokësor (natyra e vaksinës së përdorur, nëse është virus i gjallë i inaktivuar apo i modifikuar, llojet dhe shtamet e virusit të përfshira në vaksinë do të tregohen gjithashtu në certifikatë).

2.3 Për lëkurën dhe leshin e kafshëve të llojit të dhirta dhe të leshta, certifikata veterinare duhet të vërtetojë se këto produkte:

a) vijnë nga kafshë që nuk janë mbajtur në zonën e infektuar me linë e dhenve dhe të dhive; ose;

b) janë përpunuar për të garantuar asgjësimin e virusit të lisë së dhenve dhe dhive, në ambiente të kontrolluara dhe të miratuara nga Autoriteti Veterinar i vendit eksportues.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nënprodukteve të tyre dhe materialit biologjik.

4. Urdhri nr. 90, datë 13.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM

Nr. 14, datë 7.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 7.3.2024 mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (B) 2023, që u përket:

KËRKUES: BESNIK CANAJ

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga Avokatja Shtetit Irma Qosja.

INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT PRANË BASHKISË TIRANË

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1893 (300), datë 13.9.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Besnik Canaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të



interesuara, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Tiranë (IMT-ja, *pranë Bashkisë Tiranë*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Besnik Canaj ka pasur në pronësi një objekt me sipërfaqe 300 m², të ndodhur në Tiranë, i cili përdorej për servis-lavash, të regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 3718, datë 1.8.1997, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.

2. Më datë 7.7.2011, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) ka ushtruar kontroll pranë objektit dhe ka konstatuar se ndërtimi ishte pa leje. Akti i konstatimit i është përcjellë kryeinspektorit të INUK-ut, i cili me vendimin nr. 15, datë 12.7.2011 (*vendimi nr. 15/2011*) ka vendosur prishjen e objektit, si dhe me vendimin nr. 32, datë 12.7.2011 (*vendimi nr. 32/2011*) ka vendosur dënimin me gjobë në shumën 25 000 lekë. Të dyja vendimet i janë komunikuar kërkuesit me shkresën nr. 322/1 prot., datë 13.7.2011 të INUK-ut, pranë Bashkisë Tiranë, ndërsa sipas procesverbalit të datës 28.7.2011 të mbajtur nga inspektorët e INUK-ut, pranë Bashkisë Tiranë, vendimi për prishjen e ndërtimit është ekzekutuar më datë 14.7.2011.

3. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vendimet e mësipërme, më datë 14.7.2011 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 15/2011 dhe nr. 32/2011 të kryeinspektorit të INUK-ut, si dhe ka kërkuar pezullimin e zbatimit të tyre. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kërkesës së kërkuesit, më datë 25.7.2011 ka vendosur pezullimin e zbatimit të këtyre akteve.

4. Pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8885, datë 9.11.2011, ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e akteve. Vendimi është lënë në fuqi me vendimin nr. 2215, datë 27.9.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs INUK-u, pranë Bashkisë Tiranë dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-1447, datë 2.4.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Me ligjin nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar” (*ligji nr. 9780/2007*) është parashikuar se kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë do të bëhet nga IKMT-ja dhe IMT-ja, pranë njësive vendore. Për këtë qëllim, në këtë vendim, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim të njëri-tjetrit.

6. Kërkuesi më datë 21.9.2015 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi, duke kërkuar detyrimin solidar subjekteve të interesuara t’i shpërblejnë dëmin pasuror në shumën 93.299.880 lekë, të ardhur si pasojë e veprimit të tyre për prishjen e objektit servis-lavash (me konstruksion tulle, me kolona betoni, në katin e dytë me konstruksion metalik), në pronësi të kërkuesit, të ndodhur në Tiranë, veprim i kryer sipas akteve administrative të konstatuara absolutisht të pavlefshme dhe të shfuqizuara me vendimin nr. 8885, datë 9.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pas shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. 6350, datë 16.12.2015, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë së kërkuesit. Detyrimin e IKMT-së t’i shpërblejë dëmin pasuror në masën 16.325.917,8 lekë të shkaktuar nga prishja, në kundërshtim me ligjin, të objektit servis-lavash. Rrëzimin e padisë për pretendimin e shpërblimit të dëmit pasuror nga pala e paditur/subjekti i interesuar, IMT-ja, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Mbi ankimet e kërkuesit dhe të IKMT-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 739, datë 12.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6350, datë 16.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. Kërkuesi, IKMT-ja dhe Avokatura e Shtetit, brenda afateve ligjore, kanë ushtruar rekurs ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Më datë 15.10.2020, IKMT-ja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për pezullimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 273/10, datë 2.2.2021, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 739, datë 12.3.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1893 (300), datë 13.9.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 739, datë 12.3.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe



nr. 6350, datë 16.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

11. Kërkuesi, më datë 19.6.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili pas plotësimit të dokumenteve është regjistruar përfundimisht më datë 21.6.2023. Kolegji i Gjykatës, më datë 13.7.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar:

12.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, në drejtëm të:

12.1.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë për shkak të natyrës së çështjes dhe pretendimeve të parashtruara nga vetë ajo për herë të parë ka ngritur problemin ligjor të parashkrimit të padisë, ndaj duhej ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore, duke qenë se janë vënë në diskutim çështje ligji me rëndësi për praktikën gjyqësore me qëllim zhvillimin e saj në drejtëm të institutit të parashkrimit. Çështja e parashkrimit të së drejtës së ngritjes së padisë nuk është ngritur nga asnjë prej palëve gjatë procesit gjyqësor dhe, në këto kushte, asnjëra prej palëve nuk ka paraqitur argumente në këtë drejtëm.

12.1.2 *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkuesit të drejtën për të marrë përgjigje për pretendimet e ngritura. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se kërkuesi ka marrë dijeni për dëmin (shembjen e objektit) në vitin 2011 dhe nuk e ka ushtruar të drejtën e padisë brenda afatit ligjor 3-vjeçar nga dita e shembjes së objektit. Kërkuesi përpara se të kërkonte shpërblimin e dëmit ishte i detyruar t'i drejtohej Gjykatës për anulimin e vendimit nr. 15/2011 të INUK-ut për shembjen e objektit dhe shpërblimi i dëmit nuk mund të jepej pa u zgjidhur çështja e ligjshmërisë lidhur me shkaktimin e dëmit. Në këtë rast, problemet si mospasja e pronësisë së truallit dhe sidomos kompetenca e INUK-ut për të vendosur për shembjen, duhej të ishin përcaktuar përpara se të kërkohej shpërblimi i dëmit. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

Tiranë brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashkrimit, duke nisur nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, sepse, nga njëra anë, arsyeton se fakti i parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit fillon kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin duke e njësuar këtë me prishjen e objektit, të shkëputur nga elementi i kundërligjshmërisë, por, nga ana tjetër, e pranon këtë element kur shprehet se sipas nenit 17 të ligjit nr. 8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” (*ligji nr. 8510/1999*) dhe nenit 115 të Kodit Civil (KC), padia duhej të ishte ngritur brenda afatit ligjor 3-vjeçar nga momenti i ndodhjes së faktit të paligjshëm, pra pranon që veprimi i organit publik është i paligjshëm.

12.1.3 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë mundësi kërkuesit për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tij për sa i përket shqyrtimit të parashkrimit të padisë, sepse asnjë gjykatë e mëparshme nuk e kishte shqyrtuar këtë çështje.

12.1.4 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs. Në pjesën arsyetuese është mjaftuar duke u shprehur se afati i parashkrimit llogaritet nga dita e kryerjes së veprimit të organit publik dhe ky është shkak që ka arritur në përfundimin për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kjo gjykatë nuk ka gjykuar dhe nuk ka arsyetuar se në momentin e ndodhjes së veprimit, akti administrativ i nxjerrë nga organi publik nuk ishte konstatuar me vendim të formës së prerë, si një akt absolutisht i pavlefshëm. Gjykata nuk ka arsyetuar se përse elementi fajësi (veprime të kryera me faj nga organi publik) nuk duhej të merrej në konsideratë në kërkimin e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor. Një nga elementet më të rëndësishme në shkaktimin e dëmit është paligjshmëria dhe fajësia në veprimet e kryera nga subjekti që pretendohet se ka shkaktuar dëmin. Paligjshmëria dhe fajësia e organit publik është provuar se ekziston jo në momentin e ndodhjes së ngjarjes, por në momentin që është deklaruar me vendim të formës së prerë dhe një arsyetim i tillë mungon nga gjykata, çka sjell për pasojë mospasjen e një uniteti ndërmjet pjesës arsyetuese dhe asaj çka gjykata ka vendosur në dispozitivin e saj.



12.2 *Të drejtën e pronës në këndvështrim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së*, pasi duke mbajtur qëndrimin se ishte parashkruar e drejta e padisë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar jo vetëm të drejtën e aksesit, por edhe të drejtën e mbrojtjes së pronës kur arsyeton se paditësi ka qenë në dijeni të veprimeve të paligjshme të organit publik dhe ka depozituar padinë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor tej afatit ligjor 3-vjeçar. Për këtë arsye, fillimisht i është drejtuar gjykatës për anulimin e aktit si absolutisht të pavlefshëm, i cili ka shërbyer si pikënisje për cenimin e së drejtës për gëzimin e pronës, sipas KEDNJ-së, nenit 1 të protokollit nr. 1 të saj. Padia për anulimin e aktit administrativ dhe vendimet gjyqësore të dhëna nuk mund të merren të shkëputura për efekt të parashkrimit nga padia për shpërblimin e dëmit.

13. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka paraqitur parashtrime me shkrim, duke prapësuar, si vijon:

13.1 Pretendimet e kërkuarit për cenimin e gjykimit *nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara. Pretendimi se çështja e parashkrimit të padisë nuk është ngritur nga asnjë prej palëve gjatë procesit gjyqësor është i pabazuar. Pretendimi është ngritur nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në ankimin e paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit. Gjykatat kanë arsyetuar për afatin ligjor për paraqitjen e padisë në gjykatë. Pretendimi është parashtruar në rekursin e ushtruar nga Avokatura e Shtetit. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk ka administruar prova të reja dhe nuk ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat më të ulëta. Kontrolli i saj është fokusuar vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra në mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit.

13.2 Pretendimi i kërkuarit se nuk ka marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimet e parashtruara në rekurs, duke iu cenuar *e drejta e aksesit*, është i pabazuar. Gjykata e Lartë është e konceptuar si gjykatë ligji dhe investohet vetëm në çështje që kanë shkelle të rënda të ligjit procedural dhe material. Çështje të tjera që kanë të bëjnë vetëm me interpretimin e fakteve nuk janë në juridiksionin e Gjykatës së Lartë. Në rastin konkret, rekursi është shqyrtuar sipas rregullave të gjykimit për Kolegjin Administrativ, i cili, si rregull, gjykon në dhomën e këshillimit dhe në përfundim ka vlerësuar

ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Kërkuari ka marrë dijeni për rekursin dhe nuk ka paraqitur kundërrekurs, duke humbur kështu të drejtën për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në këtë gjykatë. Kërkuari nuk ndodhet në kushtet e kufizimit të së drejtës së aksesit, pasi nuk ka provuar se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet. E drejta e aksesit ose të drejta të tjera procedurale nuk garantohen domosdoshmërisht dhe vetëm duke e paraqitur çështjen në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, kërkuari nuk ka arritur të ngrejë në nivel kushtetues pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit.

13.3 Për pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, kërkuari nuk ka evidentuar asnjë argument konkret, duke u mjaftuar vetëm në fjali deklarative. Kërkuari gjatë gjykimit në shkallë të parë ka qenë i përfaqësuar nga avokati duke parashtruar pretendimet e tij. Ai ka paraqitur ankim dhe rekurs. Në rastin konkret, u është dhënë mundësia të gjitha palëve për të parashtruar pretendimet rreth çështjes dhe kjo është provuar nga fakti që palët janë njoftuar në çdo fazë të procesit, duke iu dhënë mundësi të barabarta për realizimin e mbrojtjes.

13.4 Pretendimi për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar. Vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, pretendime të ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese, ku ajo u jep përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs, duke përmbushur standardet kushtetuese të arsyetimit.

13.5 Për pretendimet në lidhje *me cenimin e së drejtës së pronës*, subjekti i interesuar nuk ka dhënë prapësime.

14. **Subjekti i interesuar, IKMT-ja**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

15. **Subjekti i interesuar, IMT-ja pranë Bashkisë Tiranë**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

16. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një



procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

18. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion, në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi në objektin e ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor me objekt shpërblimin e dëmit pasuror të ardhur si pasojë e veprimeve të kryera nga IKMT-ja në kundërshtim me ligjin për prishjen e objektit servis-lavash. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

20. Gjykata ka vlerësuar se vënia në dispozicion të palëve e vendimeve të gjykatës ua bën të njohura atyre arsyet e vendimmarrjes, duke u dhënë mundësinë të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Për rrjedhojë, si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data e marrjes dijeni efektivisht

për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Si rregull, kjo datë është ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor të arsyetuar në prani të palës, kurse kur vendimi gjyqësor nuk shpallet i arsyetuar ose kur pala nuk është e pranishme, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo e njoftimit shkresor ose elektronik të tij. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, duke zbatuar këtë standard, rezulton se vendimi nr. 00-2022-1893 (300) i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 13.9.2022. Kërkuesi, më datë 19.6.2023, së bashku me ankimin kushtetues individual, ka paraqitur në Gjykatë edhe një kopje të *e-mail-it* të datës 23.2.2023, sipas të cilit Gjykata e Lartë i ka dërguar vendimin. Për rrjedhojë, nisur nga data 23.2.2023 kur vendimi i është dërguar kërkuessit me *e-mail*, vlerësohet se ankimi kushtetues individual i paraqitur më datë 19.6.2023 është brenda afatit ligjor 4-mujor.

22. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e pronësisë.

23. Në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar për herë të parë çështjen e parashkrimit të padisë, ndërkohë që asnjë nga palët nuk e kishte ngritur këtë pretendim në dy shkallët më të ulëta të gjykimit. Sipas kërkuessit në kushtet kur çështja është gjykuar në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit, atij nuk i është krijuar mundësia për të parashtruar pretendimet lidhur me parashkrimin e padisë.

24. Në analizë të përmbajtjes së dosjes gjyqësore të administruar, Gjykata konstaton se çështja e



parashkrimit të së drejtës së padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor është parashtruar nga palët/subjektet e interesuara si gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (*shih faqen 10 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*), në Gjykatën Administrative të Apelit (*shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*), edhe në Gjykatën e Lartë (*shih faqet 12-13 të vendimit të Gjykatës së Lartë ku janë parashtruar prapësimet e palëve*) dhe gjykatat i kanë dhënë përgjigje në vendimet e tyre përkatëse.

25. Po kështu, Gjykata konstaton se fakti që çështja është gjykuar në dhomën e këshillimit nuk e ka penguar palën që të parashtronte kundërshtimet e tij në lidhje me vendimet e gjykatave më të ulëta përmes rekursit ose të paraqesë kundërrekurs për rekursin e palëve të interesuara, në të cilat është trajtuar çështja e parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit.

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet për cenimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar dhe cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit janë haptazi të pabazuara, për sa kohë ato mbështeten mbi fakte të pavërteta.

27. Në lidhje me pretendimet e tjera, për të drejtën e aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuar, në thelb, ka pretenduar se i është cenuar e drejta e pronësisë, pasi Gjykata e Lartë, duke u shprehur se afati i parashkrimit për paraqitjen e padisë llogaritet nga dita e kryerjes së veprimit të organit publik, i ka cenuar kërkuar të drejtën për t'u dëmshpërblyer për shkak të prishjes së objektit mbi bazën e vendimeve administrative të shpallura absolutisht të pavlefshme.

28. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuar, çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës, sipas të cilave prona fitohet me çdo formë klasike të parashikuar në KC dhe nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, si dhe në kuadër të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së që parashikon garantimin se askush nuk mund të privohet nga prona e tij.

29. Në vlerësimin e së drejtës së pronës së kërkuar, Gjykata konstaton se pas shfuqizimit të akteve administrative si absolutisht të pavlefshme ai ka kërkuar dëmshpërblyer për prishjen e pronës si

ndërtim i paligjshëm. Me vendimin për prishjen e pronës pa shkak të ligjshëm, kërkuar i është cenuar drejtpërdrejt e drejta e tij kushtetuese për një pronë të fituar ligjërisht sipas nenit 41, paragrafi i dytë, të Kushtetutës, me ndërtim kundërt lejes ndërtimore të organeve kompetente të kohës (*shih vendimin nr. 76, datë 9.7.1991 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor, Rajoni nr. 2, Tiranë, sipas referencës në faqen 3 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Nga ana tjetër, kërkuar është ngarkuar nga IKMT-ja edhe me pagimin e një gjobe administrative në masën 25 000 mijë lekë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se edhe gjoba është pjesë e konceptit kushtetues të pronës, pasi pagesa e një sasive të caktuar të hollash, e barasvlershme me masën e detyrimit, është një shumë e cila merret nga pasuria e individit (*shih vendimin nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata rithekson se koncepti i së drejtës së pronës është mjaft i gjerë dhe shtrihet si ndaj sendeve të paluajtshme, të luajtshme, ashtu edhe ndaj një hapësire të madhe interesash ekonomike. Gjykata në jurisprudencën e saj ka mbajtur në vëmendje faktin se sa e rëndësishme është e drejta kushtetuese e pronës private nga e cila rrjedh, rast pas rasti, e drejta për ta gëzuar, e drejta e disponimit dhe e drejta e kompensimit të pronës sipas kuadrit ligjor në fuqi (*shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa më lart, në kushtet kur argumentet e parashtruara në kërkesë, në thelb, kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës së pronës, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili, mes të tjerave parashikon se kërkesat për dëmshpërblyer, nënkuptojnë “një pasuri”, Gjykata vlerëson t'i shqyrtojë pretendimet në drejtëm të së drejtës së pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 41 dhe 42 të Kushtetutës. Pretendimet hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, ndaj bazueshmëria e tyre në themel do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

32. Kërkuar ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se ai ka marrë dijeni për dëmin (shembjen e objektit) në vitin 2011 dhe nuk e ka ushtruar të drejtën e



padisë brenda afatit ligjor 3-vjeçar nga dita e shembjes së objektit, i ka cenuar të drejtën e pronësisë dhe i ka mohuar të drejtën e aksesit. Ai fillimisht i është drejtuar gjykatës për anulimin e aktit administrativ, për shembjen e objektit, si absolutisht të pavlefshëm, pasi ai ka shërbyer si pikënisje për cenimin e së drejtës të gëzimit të pronës, sipas KEDNJ-së dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të saj.

33. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar. Gjykata e Lartë është e konceptuar si gjykatë ligji dhe investohet vetëm në çështje që kanë shkelje të rënda të ligjit procedural dhe material. Në rastin konkret, rekursi është shqyrtuar sipas rregullave të gjykimit për Kolegjin Administrativ, i cili, si rregull, gjykon në dhomën e këshillimit dhe në përfundim ka vlerësuar ndryshimin e vendimit të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Kërkuesi ka marrë dijeni për rekursin dhe nuk ka paraqitur kundërekurs, duke humbur kështu të drejtën për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në këtë gjykatë. Subjekti i interesuar nuk ka parashtruar argumente për cenimin e së drejtës së pronësisë.

34. Neni 41 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës private (*pika 1*) dhe lejon që ligji të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike (*pika 3*), të cilat lejohen vetëm përkundërt një shpërblimi të drejtë (*pika 4*).

35. Ndërsa neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

36. Gjykata ka pohuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Megjithatë, e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje (*shih vendimet nr.*

7, datë 21.2.2023; nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 18, datë 31.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

37. Në rastin kur kushtet e paraqitjes së ankimit ose të padisë, siç është afati, janë përcaktuar nga ligji, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt ligjor në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se procesi gjyqësor ka nisur me padinë e datës 21.9.2015 të paraqitur nga kërkuesi për kërkimin e detyrimit solidar të subjekteve të interesuara për të shpërblyer dëmin pasuror, në shumën 93.399.880 lekë, të ardhur si pasojë e veprimit të tyre për prishjen e objektit servis-lavazh, të ndodhur në Tiranë, veprim i kryer bazuar në aktin administrativ nr. 15/2011. Akti është konstatuar absolutisht i pavlefshëm dhe është shfuqizuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 8885, datë 9.11.2011. Si bazë ligjore e padisë, mes të tjerave, janë përcaktuar nenet 608 e vijues, 626 dhe 640 të KC-së që rregullojnë institutin e shkaktimit të dëmit dhe të shpërblimit të dëmit, si dhe ligji nr. 8510/1999, i cili në nenin 17 të tij përcakton afatin



ligjor 3-vjeçar, brenda të cilit mund të kërkohej shpërblimi për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore, duke filluar nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkaktuar atë.

40. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me afatin ligjor për paraqitjen në gjykatë të padisë ka arsyetuar se padia është depozituar në respektim të afatit specifik trevjeçar sipas ligjit të përgjithshëm civil në përputhje me nenin 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas kësaj dispozite, paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor paraqiten në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në ligjin e posaçëm. Në nenin 17 të ligjit nr. 8510/1999 kërkitimi i shpërblimit për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore, parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkaktuar atë. Në kushtet kur dëmi është konsideruar si i tillë nga paligjshmëria e veprimit të organit administrativ të konstatuar me vendim gjyqësor të formës së prerë më datë 27.9.2012, afati fillon të ecë nga kjo datë, për shkak se koha kur është konstatuar paligjshmëria e aktit, zbatimi i të cilit ka sjellë dëmin, në kuptim të ligjit është koha kur organi që ka shkaktuar dëmin mban përgjegjësinë për shpërblimin e tij. Në sinkron me këtë përcaktim, neni 120 i KC-së për dëmin jashtëkontraktor përcakton se për kërkimin e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari e ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe për personin që e ka shkaktuar. Meqenëse shpërblimi i dëmit kërkon në mënyrë kumulative disa elemente, ndër të cilët kundërligjshmëria e veprimit të organit publik që ka sjellë dëmin, ky i fundit është identifikuar me vendimin gjyqësor për paligjshmërinë e aktit administrativ që ka çuar në prishjen e objektit, ndaj afati vlerësohet se fillon në kohën kur vendimi gjyqësor konsiderohet i ekzekutueshëm (*shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*). Në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur detyrimin e subjektit të interesuar, IKMT-së, t’i paguajë kërkuarit dëmin pasuror në masën 16.325.917,8 lekë, të shkaktuar nga prishja në kundërshtim me ligjin të objektit servis-lavash dhe rrëzimin e padisë

për pretendimin e shpërblimit të dëmit pasuror nga pala e paditur, IMT-ja pranë Bashkisë Tiranë.

41. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim kërkuari, i cili ka kërkuar pranimin në tërësi të padisë, si dhe IKMT-ja që ka kërkuar rrëzimin e padisë. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar në të njëjtën linjë me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në lidhje me pretendimin për parashkrimin e padisë. Ajo ka arsyetuar se referuar momentit të marrjes dijeni për dëmin, kërkohej që atij që i është shkaktuar dëmi duhet që të ketë marrë dijeni për të gjithë komponentët e ekzistencës së dëmit të paligjshëm, ku një ndër të cilët është edhe kundërligjshmëria e veprimit të organit publik që ka sjellë dëmin. Kështu, duke qenë se kundërligjshmëria edhe organi janë identifikuar me vendimin gjyqësor për paligjshmërinë e aktit administrativ që ka prishur objektin, me të drejtë vlerësohet se afati fillon në kohën kur vendimi gjyqësor konsiderohet i ekzekutueshëm. Në rastin konkret, dëmi është konsideruar si i tillë nga paligjshmëria e veprimit të organit publik me vendim gjyqësor të formës së prerë më datë 27.9.2012 (vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë) dhe afati fillon të ecë nga kjo datë. Referuar kësaj date, rezulton se padia është paraqitur brenda afatit ligjor 3-vjeçar.

42. Ndaj vendimit kanë ushtruar rekurs, kërkuari, IKMT-ja dhe Avokatura e Shtetit. Në vijim, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar shkaqet e rekursit dhe ka vlerësuar se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është në një linjë të gabuar arsyetimi që nuk përputhet me parashikimet e ligjit material dhe procedural. Për këtë arsye, sipas saj, në kushtet kur zbatimi i ligjit procedural ose material, për rastin në shqyrtim, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve ose provave, të cilat janë të ditura që nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar se duhej ndryshuar vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe çështja duhej zgjidhur përfundimisht në themel të saj, duke vendosur rrëzimin e padisë (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

43. Gjykata, duke iu referuar përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Lartë, vëren se, në mënyrë të përmbledhur, ka trajtuar bazën ligjore ku ka mbështetur arsyetimin e saj, konkretisht nenin 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet se paditë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor paraqiten



në gjykatë, sipas afateve të parashikuara në ligjin e posaçëm nr. 8510/1999 dhe se përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore rregullohet sipas dispozitave të ligjit dhe të KC-së. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se padia administrative duhej të ishte paraqitur për gjykim brenda afatit ligjor 3-vjeçar, nga momenti i ndodhjes së faktit të paligjshëm, referuar nenit 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, nenit 17 të ligjit nr. 8510/1999, si dhe nenit 115, shkronja “dh”, të KC-së. Sipas akteve rezultojnë se paditësi/kërkuesi ka marrë dijeni prej vitit 2011, se organi publik, INUK-u (sot IKMT-ja) ka nxjerrë dhe ekzekutuar vendimin për prishjen e objektit në pronësi të tij. Me argumentin e paligjshmërisë së veprimeve të organit publik, ai ka kërkuar në gjykatë shfuqizimin e akteve administrative. Megjithatë ka qenë në dijeni të veprimeve të paligjshme të organit publik, ai ka depozituar në gjykatë padinë me objekt “shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor”, më datë 21.9.2015, pra dukshëm jashtë afatit ligjor 3-vjeçar (*shih paragrafin 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

44. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se elementi thelbësor i parashkrimit nuk është kalimi i kohës në vetvete, por është mosveprimi/pasiviteti i titullarit të së drejtës për të mbrojtur, brenda kohës së caktuar nga ligji, të drejtën e tij të cenuar ose të mohuar. Për të vlerësuar nëse ka kaluar ose jo afati i paraqitjes së padisë, si pasojë e mosveprimit të titullarit të saj, me rëndësi është përcaktimi i saktë i momentit të lindjes së të drejtës, moment nga i cili fillon llogaritja e afatit. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se momenti nga i cili ka filluar llogaritja e afatit për të kërkuar dëmshpërblim është data 12.7.2011 kur INUK-u ka nxjerrë vendimin për prishjen e objektit në pronësi të kërkuesit dhe depozitimi i padisë për shpërblimin e dëmit më datë 21.9.2015 është dukshëm jashtë afatit ligjor 3-vjeçar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se kërkuesi ka qenë në dijeni të dëmit të pësuar dhe të subjektit (organit publik) që e ka shkaktuar, duke plotësuar në mënyrë kumulative kriteret e nenit 120 të KC-së (*shih paragrafët 23 dhe 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Si pasojë e këtij interpretimi, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se padia është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe, për këtë shkak, ka vendosur rrëzimin e padisë, duke ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta që kishin shqyrtuar themelin e pretendimeve dhe pranuar pjesërisht ato.

45. Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se kërkuesi ka kërkuar dëmshpërblim tej afatit ligjor 3-vjeçar, sipas nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 8510/1999 duke analizuar elementet e parashikuara në nenin 120 të KC-së, për kërkimin e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor, sipas të cilit parashkrimi i padisë fillon nga dita kur i dëmtuari ka ditur ose duhej të dinte për dëmin e pësuar dhe personin që e ka shkaktuar. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formalist dhe nuk ka analizuar në mënyrë kumulative katër kushtet e ekzistencës së përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, të përcaktuar në nenin 608 të KC-së: (i) ekzistencën e dëmit; (ii) ekzistencën e paligjshmërisë së veprimit juridik; (iii) ekzistencën e fajit; (iv) ekzistencën e lidhjes shkakësore. Në mënyrë të veçantë në çështjen konkrete, në momentin e prishjes së objektit, kanë qenë të qarta për kërkuesin vetëm dy nga kushtet e mësipërme: ekzistenca e dëmit dhe lidhja shkakësore, por ende nuk ishin të provuara dhe vireshin në diskutim dy kushtet e tjera: kundërligjshmëria dhe fajti i kryerjes së veprimeve të organit publik. Për kundërligjshmërinë dhe fajin palët ndërgjyqëse, kërkuesi dhe subjekti i interesuar, nuk ishin në dijeni, derisa vendimi përfundimtar i gjykatës mori formë të prerë, i cili përcaktoi se akti administrativ për prishjen e objektit ishte i paligjshëm dhe, si i tillë, i kryer me faj nga organi publik. Edhe pse gjykatat e faktit kishin arsyetuar se elementet e kundër-ligjshmërisë dhe të fajit të veprimeve të organeve janë vërtetuar ditën që vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, ndaj afati ligjor 3-vjeçar fillonte në atë ditë, Gjykata e Lartë nuk është ndalur në këtë drejtim dhe nuk ka dhënë shpjegim se përse arsyetimi i gjykatave të faktit ishte i pabazuar. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se në nenin 14 të ligjit nr. 9780/2007 parashikohet se kundër vendimit të IKMT-së dhe të njësisë vendore mund të paraqitet ankimi drejtpërdrejt në gjykatë. Në rast se, në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati që ka dhënë vendimin për shpërblimin për dëmin e shkaktuar. Gjykata vëren se përmbajtja e kësaj dispozite nuk rezultojnë të jetë analizuar nga Gjykata e Lartë.

46. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim



të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme kushtetuese në raport me faktet e çështjes në shqyrtim, vlerëson se qëndrimi i Gjykatës së Lartë, në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, i bazuar në një arsyetim formalist dhe interpretim të ngushtë të së drejtës së aksesit, nuk përputhet me kuptimin e qëllimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është shprehur se interpretimi i ngushtë i së drejtës së aksesit, që garantohet nga neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e këtij parashikimi. Rëndësia e ushtrimit të të drejtave procedurale ndryshon në varësi të qëllimit të veprimeve, të cilat personi në fjalë synon t'i ushtrojë përpara gjykatave (*shih çështjen Nataliya Mikbaylenko kundër Ukrainës, aplikimi nr. 49069/11, datë 30.5.2013, §37*).

48. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në themel të procesit gjyqësor qëndron e drejta e pronës, një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit, vlerëson se Gjykata e Lartë e ka bërë joefektive të drejtën e aksesit të kërkuarit për të kërkuar dëmshpërblim, si mjeti i përdorur nga ai kundër arbitraritetit të ndërhyrjes së organeve shtetërore në pronën private. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronësisë i lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit është i bazuar dhe se vendimi i Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar.

49. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor,

sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, është i bazuar, ndaj dhe kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1893 (300), datë 13.9.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 7.3.2024.

Shpallur, më 8.4.2024.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Elsa Toska, Sonila Bejtja, Ilir Toska

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen që i përket kërkuarit Besnik Canaj me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1893 (300), datë 13.9.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë*”, bashkohemi me shumicën për pabazueshmërinë e pretendimeve të kërkuarit lidhur me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit, por jemi kundër qëndrimit të saj për sa i përket pranimin si të bazuar të pretendimit të tij për cenimin e së drejtës së pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit. Në vlerësimin tonë edhe ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar,



ndaj kërkesa e tij duhej të rrëzohej. Në vijim, do të parashtrijmë argumentet për qëndrimin tonë si gjyqtarë në pakicë.

2. Sipas akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se inspektorët e INUK-ut, mbështetur në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar (*ligji nr. 9780/2007*), kanë ushtruar kontroll pranë një objekti të kërkuarit, të ndodhur në Tiranë, duke konstatuar se për objektin nuk kishte leje ndërtimi të lëshuar nga organi kompetent. Për këtë konstatim, kryeinspektori i INUK-ut ka nxjerrë vendimin nr. 15, datë 12.7.2011 (*vendimi nr. 15/2011*) për prishjen e objektit. Në ditët në vijim, konkretisht më datë 14.7.2011, sipas procesverbalit të datës 28.7.2011 të mbajtur nga inspektorët e INUK-ut, objekti i kërkuarit është prishur.

3. Pas njoftimit të vendimit për prishjen e objektit, më datë 14.7.2011, kërkuari e ka kundërshtuar këtë vendim në gjykatë me pretendimin se ishte një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Padia e kërkuarit është pranuar dhe vendimi nr. 15/2011 i kryeinspektorit të INUK-ut është shfuqizuar si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm me vendimin nr. 8885, datë 9.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë më datë 27.9.2012, pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

4. Në vijim, më datë 21.9.2015, kërkuari i është drejtuar përsëri gjykatës tashmë me një padi për shpërblimin e dëmit pasuror të ardhur si pasojë e veprimit të prishjes së objektit nga të paditurit, IKMT-ja dhe IMT-ja (*subjektet e interesuara*), me pretendimin se ky veprim ishte i paligjshëm, ndërsa vendimi për prishjen e objektit (vendimi nr. 15/2011) ishte gjetur i tillë me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6350, datë 16.12.2015, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuarit, duke detyruar subjektin e interesuar, IKMT-në, t’i paguajë kërkuarit dëmin pasuror në vlerën 16.325.917,8 lekë, shkaktuar nga prishja e objektit në kundërshtim me ligjin. Nga ana tjetër, gjykata ka rrëzuar padinë për masën tjetër të dëmit pasuror të kërkuar në objektin e saj, sikundër e ka rrëzuar edhe atë për sa i përket subjektit tjetër të interesuar, IMT-së pranë Bashkisë Tiranë.

5. Gjykata administrative e shkallës së parë, ndër të tjera, nuk e ka pranuar prapësimin e të paditurit, IKMT-së, dhe Avokaturës së Shtetit për parashkrimin e së drejtës së padisë së kërkuarit, duke

arsyetuar se padia është paraqitur brenda afatit ligjor 3-vjeçar të parashikuar nga neni 115, shkronja “dh”, i Kodit Civil (KC), si dhe neni 18, pika 4, i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), i cili referon në ligjin specifik, që në këtë rast është ligji nr. 8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” (*ligji nr. 8510/1999*), sipas nenit 17 të të cilit kërkimi i shpërblimit për dëmet e shkaktuara nga organet e administratës shtetërore parashkruhet brenda 3 vjetësh nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkaktuar atë. Sipas asaj gjykate, në kushtet kur dëmi është konsideruar si i tillë nga paligjshmëria e veprimit të konstatuar me vendim gjyqësor të formës së prerë më datë 27.9.2012 (vendimi i gjykatës së apelit), afati fillon të ecë nga kjo datë, për shkak se koha kur është konstatuar paligjshmëria e aktit administrativ, zbatimi i të cilit ka passjellë dëmin, është koha kur organi që ka shkaktuar dëmin mban përgjegjësinë për shpërblimin e tij, çka është në sinkron edhe me përcaktimin e nenit 120 të KC-së. Meqenëse shpërblimi i dëmit, vijon ajo, kërkon në mënyrë kumulative disa elemente, ndër të cilat kundërligjshmëria e veprimit të organit publik që ka sjellë dëmin, ky i fundit është identifikuar me vendimin gjyqësor për paligjshmërinë e aktit administrativ që ka çuar në prishjen e objektit, ndaj afati vlerësohet se fillon në kohën kur vendimi gjyqësor konsiderohet i ekzekutueshëm. Ndaj këtij vendimi, për pjesën e rrëzuar të padisë, ka paraqitur ankim kërkuari. Po kështu, për pjesën e pranuar të padisë, ka paraqitur ankim i padituri, IKMT-ja, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin tërësisht të padisë, ndër të tjera, edhe me pretendimin e parashkrimit të së drejtës së padisë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 739, datë 12.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Për sa i përket pretendimit të ngritur në ankim nga i padituri (subjekti i interesuar IKMT-ja) në lidhje me parashkrimin e padisë, ajo gjykatë ka arsyetuar në të njëjtën linjë me gjykatën administrative të shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs i padituri, IKMT-ja, dhe Avokatura e Shtetit, duke ngritur si shkak për cenimin e vendimit, ndër të tjera, edhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat në lidhje me parashkrimin e padisë.



7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1893 (300), datë 13.9.2022, ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta dhe rrëzuar tërësisht padinë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se qëndrimi i mbajtur nga dy gjykatat më të ulëta është në një linjë të gabuar arsyetimi që nuk përputhet me parashikimet e ligjit material dhe procedural dhe, për këtë arsye, në kushtet kur zbatimi i ligjit procedural ose material, për rastin në shqyrtim, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve ose provave, të cilat janë të ditura që nuk hyjnë në juridiksionin e Gjykatës së Lartë, vlerësohet se çështja duhej të zgjidhej përfundimisht në themel nga ajo, duke u ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta dhe rrëzuar padia për shkak të parashkrimit të saj.

8. Lidhur me këtë konkluzion, pasi ka analizuar rrethanat e faktit të pranuar nga gjykatat më të ulëta në raport me përcaktimet e bëra në nenin 18, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, në nenet 1 dhe 17 të ligjit nr. 8510/1999, si dhe në nenet 112, 115, shkronja “dh” dhe 120 të KC-së, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se padia administrative e kërkesit për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor është parashkuar, ndërsa nuk është paraqitur për gjykim brenda afatit ligjor 3-vjeçar, nga momenti i ndodhjes së faktit të paligjshëm. Sipas saj, neni 112 i KC-së përmban dy elemente thelbësore në lidhje me parashkrimin e padisë: (i) kalimin e një periudhe kohe të caktuar; (ii) mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe, ku kushti i parë përbën atë që quhet afat i parashkrimit të padisë, ndërsa kushti tjetër konsiston në mosveprimin e titullarit të së drejtës në rastet kur ai mund dhe duhej të vepronte, ndërkohë që për të vlerësuar nëse ka kaluar ose jo afati i paraqitjes së padisë, si pasojë e mosveprimit të titullarit të saj, është me rëndësi përcaktimi i saktë i momentit të lindjes të së drejtës nga i cili fillon llogaritja e afatit. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se referuar nenit 17, pika 1, të ligjit nr. 8510/1999 dhe nenit 120 të KC-së, ligjvënësi ka vendosur dy kushte që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative e të domosdoshme (*sine qua non*), që afati i parashkrimit të padisë të quhet i nisur ligjërisht. Së pari, i dëmtuari të ketë dijeni ose, sipas rrethanave, duhej të kishte dijeni për dëmin që i është shkaktuar. Së dyti, i dëmtuari të marrë dijeni ose duhej të merrte dijeni për personin që e ka shkaktuar atë, në mënyrë që t'i ketë të gjitha mundësitë për të plotësuar detyrimet procedurale

dhe për të investuar gjykatën me padi. Mbi këtë analizë ligjore, në vijim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në momentin që organi publik ka nxjerrë vendimin për prishjen e objektit të kërkesit dhe e ka ekzekutuar atë në vitin 2011, janë plotësuar në mënyrë kumulative të dyja kushtet e parashikuara nga ligji, ndërsa kërkesi ka ditur dëmin e pësuar, që ishte prishja e objektit, si dhe personin që e ka shkaktuar atë, që është pikërisht IKMT-ja. Megjithatë, pavarësisht se ka qenë në dijeni të veprimeve të paligjshme të organit publik, kërkesi e ka depozituar në gjykatë padinë me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor vetëm më datë 21.9.2015, pra dukshëm tej afatit ligjor 3-vjeçar (*shih paragrafët 21 - 26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

9. Shumica ka arritur në përfundimin se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Sipas saj: “(..). *Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formalist dhe nuk ka analizuar në mënyrë kumulative katër kushtet e ekzistencës së përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, të përcaktuara në nenin 608 të KC-së: (i) ekzistenca e dëmit; (ii) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit juridik; (iii) ekzistenca e fajit dhe (iv) ekzistenca e lidhjes shkakësore. Në momentin e prishjes së objektit kanë qenë të qarta për kërkesin vetëm dy nga kushtet e mësipërme: ekzistenca e dëmit dhe lidhja shkakësore, por nuk ishin ende të provuara dhe vireshin në diskutim dy kushtet e tjera: kundërligjshmëria dhe faji i kryerjes së veprimeve të administratës publike. Kundërligjshmëria dhe faji nuk ishin në dijeni të palëve ndërgjyqëse, kërkesit dhe subjektit të interesuar derisa të merrte formë të prerë vendimi përfundimtar i gjykatës që përcaktoi që akti administrativ për prishjen e objektit ishte i paligjshëm dhe si i tillë i kryer me faj nga organi administrativ. Edhe pse gjykatat e faktit kishin arsyetuar se elementet e kundërligjshmërisë dhe të fajit të veprimeve të organeve të administratës janë vërtetuar ditën që vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, ndaj afati 3 vjeçar fillonte në këtë ditë, Gjykata e Lartë nuk është ndalur në këtë drejtim dhe nuk ka dhënë shpjegim se përse arsyetimi i gjykatave të faktit ishte i pabazuar. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë e evidenton se në nenin 14 të ligjit nr. 9780/2007, të ndryshuar, parashikohet se kundër vendimit të IKMT-së dhe të njësisë vendore mund të paraqitet ankim drejtpërdrejt në gjykatë. Në rast se, në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektorati që ka dhënë vendimin shpërblimin për dëmin e shkaktuar. Gjykata vëren se përmbajtja e kësaj dispozite nuk rezulton të jetë analizuar nga Gjykata e Lartë”.* Në vijim, shumica



ka vlerësuar se: *“Qëndrimi i Gjykatës së Lartë, në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta, i bazuar në një arsyetim formalist dhe interpretim të ngushtë të së drejtës së aksesit, që nuk përputhet me kuptimin e qëllimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së” (shih paragrafët 45 dhe 47 të vendimit).*

10. Ne, gjyqtarët në pakicë, ndryshe nga shumica, mendojmë se Gjykata e Lartë nuk i ka cenuar kërkesat të drejtën e pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

11. Për këtë përfundim mbajmë parasysh se neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike (shih vendimet nr. 56, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 15.5.2014; nr. 17, datë 19.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor

ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Po kështu, Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 9, datë 26.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese). Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 23, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 7, datë 27.4.2005; nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin në shqyrtim, pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë kërkesi e ka argumentuar me faktin se Gjykata e Lartë, fillimin e afatit të parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor e ka lidhur me momentin kur ai si i dëmtuar ka marrë dënimin për dëmin dhe organin publik që e ka shkaktuar, duke e njëzuar këtë moment me atë të prishjes së objektit, të shkëputur nga elementi i kundërligjshmërisë së veprimit, megjithëse vetë ajo shprehet se padia duhej të ishte ngritur brenda afatit ligjor 3-vjeçar nga momenti i ndodhjes së faktit të paligjshëm, duke pranuar në këtë mënyrë elementin e kundërligjshmërisë së veprimit të prishjes së objektit, kundërligjshmëri e cila është konstatuar pas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

15. Referuar jurisprudencës kushtetuese, vlerësojmë se argumentet e parashtruara nga



kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë kanë të bëjnë me çështje të interpretimit të ligjit, dhe, si të tilla, ato i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Në vlerësimin tonë, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese, Gjykata e Lartë ka dhënë mjaftueshëm argumente për mënyrën e interpretimit të ligjit nga ana e saj në lidhje me fillimin e afatit të parashkrimit të padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor dhe plotësimin e tij në rastin konkret, interpretim ky që, nga ana tjetër, nuk duket të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Fakti që dy gjykatat më të ulëta e kanë interpretuar ndryshe ligjin në lidhje me fillimin e afatit të parashkrimit të padisë, duke pranuar se ai fillon pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor që konstaton paligjshmërinë e aktit administrativ që ka shërbyer si bazë e veprimit administrativ të prishjes së objektit, nuk nënkupton që Gjykata e Lartë i ka cenuar kërkuesit të drejtën e aksesit ose që arsyetimi i vendimit të saj nuk plotëson standardet kushtetuese në këtë drejtim. Duke arsyetuar se ligji përcakton fillimin e afatit të parashkrimit të padisë së shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor me momentin e dijenisë nga i dëmtuari për dëmin dhe për personin (organin publik) që ia ka shkaktuar atë, Gjykata e Lartë nuk ka pranuar përfundimin e gjykatave më të ulëta se ky moment i korrespondon atij të konstatimit, nga organi i ngarkuar nga ligji (gjykata), të paligjshmërisë së aktit administrativ, ekzekutimi i të cilit i ka shkaktuar dëm kërkuesit.

16. Ndërsa ka një dallim midis paligjshmërisë ose kundërligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit të dëmit, qoftë ky dhe veprim ose mosveprim administrativ me atë të konstatimit, prej organit publik kompetent, të paligjshmërisë së aktit administrativ që ka shërbyer si bazë e veprimit ose mosveprimit administrativ të dëmit, vlerësojmë se kundërligjshmëria është një koncept ligjor thelbi i së cilës lidhet me pasojën e veprimit ose mosveprimit (dëmtimi i interesave të ligjshëm të personave fizikë ose juridikë). Po kështu, në vlerësimin tonë, është çështje e ligjit dhe e mënyrës së interpretimit të tij nga gjykatat e zakonshme nëse konstatimi i paligjshmërisë, nga organi publik kompetent, i aktit administrativ që ka shërbyer si bazë e veprimit ose mosveprimit administrativ të dëmit, përbën, sipas ligjit, parakusht për ngritjen e padisë së shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor ose kjo e fundit mund të ngrihet edhe brenda së njëjtës padi për konstatimin

e paligjshmërisë së aktit administrativ apo edhe veçmas, por, gjithsesi, brenda afatit ligjor 3-vjeçar nga çasti kur i dëmtuari merr dijeni për dëmin dhe organin që e ka shkaktuar atë. E tillë është, gjithashtu, edhe çështja nëse ngritja e padisë për konstatimin e paligjshmërisë së aktit administrativ përbën rrethanë ligjore që çon në ndërprerjen e parashkrimit të padisë së shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor dhe, për pasojë, imponon fillimin e një afati të ri parashkrimi nga dita që merr formë të prerë vendimi i gjykatës për konstatimin e paligjshmërisë së aktit administrativ.

17. Në kushtet kur çështja e parashkrimit të së drejtës së padisë është vënë në diskutim gjatë të gjithë procesit gjyqësor dhe kërkuesi ka pasur mundësi të paraqesë argumentet e tij e të debatojë për këtë çështje, mendojmë se në ushtrimin e juridiksionit të saj, Gjykata e Lartë ka vendosur për mosmarrëveshjen mbi të njëjtat fakte të pranura nga gjykatat e faktit, duke e bazuar kontrollin e saj vetëm mbi mënyrën e zbatimit nga ato të ligjit. Nga ana tjetër, ndërsa gjykatat janë shprehur përfundimisht për të drejtën subjektive të pretenduar nga kërkuesi, jemi përpara një zgjidhjeje përfundimtare të mosmarrëveshjes së ngritur nga ai. Në të kundërt me qëndrimin e shumicës, sipas së cilës arsyetimi i Gjykatës së Lartë është rezultat i interpretimit të ngushtë të së drejtës së aksesit, vlerësojmë se kjo gjykatë, në përputhje me funksionin e saj për kontrollin e vendimarrjeve të gjykatave më të ulëta dhe për të interpretuar normën e zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, ka paraqitur argumente të mjaftueshme, të qarta dhe shteruese në lidhje me përfundimin e arritur nga ajo. Interpretimi i ligjit të posaçëm nga Gjykata e Lartë ose fakti, i evidentuar nga shumica, se ajo nuk ka arsyetuar në lidhje me përmbajtjen e nenit 14 të ligjit nr. 9780/2007, në vlerësimin tonë janë çështje të natyrës ligjore, ndaj, si të tilla, nuk i përkasin juridiksionit kushtetues.

18. Sikurse Gjykata ka theksuar, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë edhe mënyrën e zbatimit të ligjit material nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 22, datë 1.11.2022; nr. 16, datë 16.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Përveç sa më lart, edhe pse nuk vëmë në dyshim jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me rastet e ndërhyrjes së Gjykatës së Lartë ku për shkak të



vendimeve të gjykatave më të ulëta janë vënë në dyshim të drejtat themelore të individit, vlerësojmë se kjo qasje ka qenë e kujdesshme, duke respektuar rolin e Gjykatës së Lartë, pasi, sikurse edhe vetë shumica e ka evidentuar, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, por ndërhyrja e Gjykatës së Lartë nuk ka qenë arbitrare dhe e paarsyeshme, ndaj vendimi i saj nuk i ka cenuar kërkesat të drejtën e pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, arsyetim i cili nuk rezultoi të jetë në kundërshtim me standardet kushtetuese për të drejtën për proces të rregullt ligjor.

19. Në përfundim, në kuptim të normave kushtetuese, standardeve të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës dhe fakteve të natyrës kushtetuese, vlerësojmë se pretendimi i kërkesit për cenimin e së drejtës së pronësisë të lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i pabazuar. Për rrjedhojë, mendojmë se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës, ndërsa ajo në tërësi është e pabazuar.

Anëtarë: Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska

VENDIM

Nr. 30, datë 27.3.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ARÇOVA”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, nenit 38, pika 1, germa “a”, dhe nenit 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a” dhe 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,

datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 242/5 prot., datë 29.2.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Arçova’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 242 prot., datë 25.1.2024, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Arçova”, me kapacitet prodhues 1280 kw, në Përroin e Arçorvës, degë e përroit të Seltës dhe Holtës, me derdhje në lumin Shkumbin, Bashkia Elbasan, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 15, datë 6.2.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.2.2024 dhe 8.2.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.2.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 242/3 prot., datë 12.2.2024, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht; dhe

- me shkresën me nr. 242/4 prot., datë 19.2.2024, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Subjekti disponon leje të vlefshme të përdorimit të burimit ujor, e cila mban datën 22.11.2023 dhe është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare (deri më 22.11.2028). Ashtu si dhe në rastet analoge do t'i lihet detyrë shoqërisë të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor brenda datës 22.11.2028 dhe në rast se subjekti nuk e depoziton këtë leje brenda afatit të mësipërm dhe



ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arçova”, me kapacitet të instaluar 1280 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Arçova”, brenda datës 21.11.2028.

3. Në rast se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor, sikurse përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 31, datë 27.3.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “COSMOGRAL” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 606/5 prot., datë 20.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Cosmogral’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Cosmogral” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 606 prot., datë 8.2.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 19.2.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.2.2024 dhe 22.2.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.3.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 606/3 prot., datë 23.2.2024, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.



- Shoqëria me shkresën me nr. 606/4 prot., datë 13.3.2024 shoqëria përcolli në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Cosmogral” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar, në zbatim të nenit 9, të rregullores, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat: “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.4, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-(pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 32, datë 27.3.2024

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,

rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 130/18 prot., datë 26.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2417 prot., datë 17.11.2023, paraqiti kërkesën për pajisje me licencë për prodhimin e energjisë elektrike dhe Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 354, datë 1.12.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 2.12.2023 dhe 4.12.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 11.12.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, nisur nga nevoja për të pasur kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit shtesë të depozituar nga ana e saj dhe/ose shkëmbimin e një korrespondence të mëtejshme me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 381, datë 28.12.2023, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit shtesë të depozituar nga shoqëria, ka rezultuar se mbetet ende dokumentacion i paplotësuar dhe po ashtu ka lindur nevoja që vetë ERE t'i drejtohet me kërkesë për informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

- Në këtë rrethana, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 11, datë 29.1.2024, u vendos zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë pune e vendimarrjes përfundimtare e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për



licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. ERE, me shkresën nr. 130/8 prot., datë 5.2.2024, ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 11/2024, duke i evidentuar dhe dokumentacionin që mbetej ende pa plotësuar nga ana e saj.

- ERE, me shkresën nr. 130/7 prot., datë 5.2.2024, iu drejtua AMBU-së, në lidhje me statusin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor dhe AMBU-ja në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/12 prot., datë 9.2.2024, ka informuar se “Drini Bulqizë” sh.p.k. ka aplikuar për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor dhe aktualisht ky aplikim është në fazën e trajtimit nga strukturat përkatëse në AMBU. Në këto rrethana, rezulton se “Drini Bulqizë” sh.p.k. nuk disponon aktualisht një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Polemi”, por është në proces rinovimi të kësaj lejeje.

- Me shkresën nr. 130/9 prot., datë 5.2.2024, ERE i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me vlefshmërinë e VNM-së paraprak, edhe AKM-ja, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/14 prot., datë 16.2.2024, ka informuar ERE-n se nga verifikimi i bazës së të dhënave rezulton se ka dorëzuar raport monitorimi për periudhën korrik 2019–janar 2020... Subjekti “Drini Bulqizë” është inspektuar në datën 19.8.2019 dhe nuk rezulton të ketë shkelje të kërkesave ligjore. Deklarata mjedisore apo vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për atë kohë sa është i vlefshëm dhe dokumenti i miratimit të zhvillimit përkatës për projektin. Për sa informuar nga AKM-ja e duke qenë se HEC është ndërtuar tashmë, rezulton se shoqëria nuk ka shkelur kërkesat ligjore të VNM-së paraprake.

- Me shkresën nr. 130/10 prot., datë 5.2.2024, ERE i është drejtuar MIE-s me kërkesën për informacion/qëndrim, në lidhje me ndryshimet përkatëse në vlerën e investimit dhe kohën e ndërtimit të HEC “Polemit”, në referencë të përcaktimeve të kontratës me nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.1.2018, ashtu si dhe për sa përcaktuar në raportin e AKBN-së, mbi testimin e kryer më datë 11.1.2024.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 130/17 prot., datë 20.3.2024, MIE ka vënë në dijeni ERE-n mbi shkresën drejtuar shoqërisë “Drini

Bulqizë” sh.p.k., ku në kuadër të monitorimit të kontratës për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC “Polemi”, bën me dije se AKBN-ja, me shkresat e datës 15.2.2024 dhe 25.2.2024, dhe ka informuar MIE-n mbi gjendjen aktuale të hidrocentralit “Polemi” dhe mbi mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e shoqërisë. Në përfundim, referuar këtyre shkresave, MIE ka kërkuar nga ana e shoqërisë përgjigjen me argumentet bindëse. Për sa përcaktuar në këtë shkresë, vlerësohet që ERE, përpara se të marrë një vendim përfundimtar në lidhje me licencimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., duhet të presë që MIE të dalë me një qëndrimin përfundimtar në lidhje me mospërmbushjen e detyrimeve kontraktore apo vlefshmërinë e kontratës nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.1.2018.

- Shoqëria, në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, pikës 1.3, germës “a”, të rregullores, ka depozituar në ERE shkresën e datës 27.2.2024, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, drejtuar subjektit “Drini Bulqizë” sh.p.k., në të cilën përcaktohet se, në përgjigje të kërkesës së datës 26.2.2024, të bërë nga shoqëria mbi gjendjen e detyrimeve të saj, subjekti “Drini Bulqizë” sh.p.k. nuk ka detyrime tatimore për llojin e tatimit të kërkuar nga ana juaj. Për sa më sipër, konstatohet se kjo shkresë është depozituar në ERE vetëm në format elektronik dhe nuk rezulton që të jetë depozituar kërkesa që vetë shoqëria i ka drejtuar organit tatimor, për të kuptuar nëse në objektin e saj janë përfshirë dhe detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndaj kjo pikë e rregullores nuk është plotësuar tërësisht nga shoqëria.

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.”

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të



miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se: Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Për sa parashikuar nga KPA-ja dhe rregullorja, duke qenë se leja e përdorimit të burimit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike dhe qëndrimi/miratimi përkatës i MIE-s në kuadër të vlefshmërisë së kontratës së nënshkruar me shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., përbëjnë dokumente thelbësore të kësaj procedure, vlerësohet të pezullohet vendimmarrja e Bordit për kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitim në ERE të: lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujqor, qëndrimin përfundimtar të MIE-s, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC ‘Polemi’ me kapacitet prodhues 1.751 mw”, shkresën e DRT Dibër në format origjinal/fotokopje e njësuar me origjinalin, si dhe vërtetimin që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Polemi”, deri kur të depozitohet në ERE:

a) leja e rinovuar e përdorimit të burimit ujqor për prodhim energjie nga HEC “Polemi”;

b) qëndrimi përfundimtar i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e HEC ‘Polemi’ me kapacitet prodhues 1.751 mw”;

c) shkresa e Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër, datë 27.2.2024, në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

d) vërtetimi që shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2. Ky vendim është objekt rishikimi në kuadër të depozitimit të secilit prej dokumenteve të përcaktuara në pikën 1.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 33, datë 27.3.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 690/1 prot., datë 28.2.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Protergia Energy Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:



- Shoqëria “Protergia Energy Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 690 prot., datë 22.2.2024, ka paraqitur aplikimin për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke kërkuar dhe vijmësinë e procedurës së licencimit me procedurë të përshpejtuar, pasi shoqëria “Protergia Energy Albania” sh.p.k. (kompani bijë e “Protergia Energy SA”, me seli në Athinë të Greqisë), kërkon të regjistrohet pranë Bursës Shqiptare të Energjisë, të themeluar në Shqipëri.

- Për sa i përket kërkesës për procedurë të përshpejtuar, ajo nuk plotëson kriteret e nenit 37, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, pasi aplikuesi nuk ka dhënë një shkak të arsyeshëm për këtë kërkesë, ndaj vlerësohet të vijohet me procedurën e zakonshme të licencimit, sipas kërkesave dhe afateve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.4, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Protergia Energy Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Protergia Energy Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 35, datë 27.3.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ENSCO TRADING (ALBANIA)” SHPK, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 586/7 prot., datë 26.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Enesco Trading (Albania)’ sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Enesco Trading (Albania)” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 586/1 prot., datë 9.2.2024 dhe nr. 586/2 prot., datë 15.2.2024, ka përcjellë nëpërmjet adresës së e-mail-it të plotësuar në anglisht, aneksin 1 të “Rregullores për procedurat



dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- ERE, me shkresën nr. 586/3 prot., datë 16.2.2024, i ka bërë me dije shoqërisë se aplikimi nuk është sjellë në formën e duhur dhe ka kërkuar të bëhen saktësimet/plotësimet përkatëse referuar kërkesave të rregullores së licencimit, nenit 8, pika 3, dokumentacioni duhet të depozitohet në gjuhën shqipe, në format origjinal/njësuar me origjinalin, si dhe një kopje në format elektronik (CD ose USB).

- Shoqëria nëpërmjet *e-mail-it* protokolluar në ERE nr. 586/4 prot., datë 19.2.2024, ka kërkuar informacion shtesë, në lidhje me këtë aplikim, i cili konsistonte nëse është marrë nga ana jonë pagesa e aplikimit bërë nga shoqëria, si dhe nëse është e plotë forma me dokumentacionin e përcjellë së fundmi prej saj. ERE ka vijuar me kthim përgjigje nëpërmjet adresës së *email-it*, e cila në vijim edhe është protokolluar me nr. 586/5 prot., datë 20.2.2024 dhe i ka risjellë në vëmendje, duke i referuar shkresën e përcjellë më në ERE me nr. 586/3, datë 16.2.2024, me anë të së cilës ka bërë sqarimet mbi saktësimin e dokumentacionit/plotësimet përkatëse.

- Me shkresën nr. 586/6 prot., datë 4.3.2024, shoqëria “Ensco Trading (Albania)” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 450, seria T19, është 6.9.2024).

- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 4.3.2024, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Ensco Trading (Albania)” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”, si dhe nenin 16, pika 7, por, në kuadër të një dosjeje të plotë, vlen të informojë, në lidhje me sa më poshtë:

Neni 16, “Rinovimi i licencës”

- Germa “b”:

Shoqëria duhet të sjellë informacion më të plotë, në lidhje me dokumentacionin për të cilin shprehet

se nuk ka pësuar ndryshim që nga momenti i licencimit pranë ERE-s.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ensco Trading (Albania)” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 7.9.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 36, datë 27.3.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 361, DATË 7.12.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GEALB ENERGY’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET ‘GURI I BARDHË 1’ DHE ‘GURI I BARDHË 2’”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me



vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 650/1 prot., datë 12.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 361, datë 7.12.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gealb Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet ‘Guri i Bardhë 1’ dhe ‘Guri i Bardhë 2’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 361, datë 7.12.2023, ka licencuar shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1”, “Guri i Bardhë 2”, me kapacitet të instaluar 9300 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, duke i lënë kusht shoqërisë që të informojë ERE-n, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentraleve brenda datës 3.2.2024, në rast se nuk ka filluar ende punimet atëherë të depozitojë VNM e rinovuar brenda kësaj date.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën nr. 2042/18 prot., datë 7.12.2022. Me me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 650 prot., datë 16.2.2024, shoqëria ka bërë me dije se nuk ka filluar ende punimet për ndërtimin e HEC dhe në rrethanat kur afati i deklaratës mjedisore tashmë ka përfunduar, ajo po përgatit aplikimin për një deklaratë të re, pasi legjislacioni mjedisor nuk parashikon rinovim, por aplikim nga e para, duke marrë angazhimin për të informuar ERE-n, në lidhje me aplikimin për lejen e re mjedisore.

- Duke qenë se në marrjen e vendimit nr. 361, datë 7.12.2023, shoqëria dispononte deklaratë mjedisore të vlefshme, i është lënë kushti përkatës për raportimin e fillimit të punimeve ose depozitimin e deklaratës së rinovuar/të re, por duke marrë në konsideratë se shoqëria nuk filloi punimet brenda afatit të vlefshmërisë së saj e nuk është pajisur ende me një deklaratë të re, vlerësohet të ndryshohet pika 2 e këtij vendimi dhe t'i lihet kusht asaj të depozitojë në ERE deklaratën mjedisore të re sapo ta disponojë, e gjithashtu në rrethanat kur nuk disponon më një deklaratë të vlefshme mjedisore, të vendoset kushti që ta depozitojë atë në ERE përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 10, të kontratës së koncesionit të formës BOT, me nr. 1139 rep., nr. 437 kol., datë 21.4.2017, nënshkruar mes Ministrinë së Energjisë dhe Industrisë e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k., ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit nr. 890 rep., nr. 263 kol., datë 28.3.2022, përcaktohet se afatet për ndërtimin e veprës mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

- Për sa më sipër cituar, e duke qenë se gjatë licencimit shoqëria ka bërë me dije se nuk i kishte nisur ende punimet dhe ishte në fazën e marrjes së miratimit nga MIE për shtyrjen e afatit të marrjes së lejeve dhe miratimeve të nevojshme për projektin, në referencë të përcaktimeve të kontratës së koncesionit të sipërcituar, vlerësohet që po ashtu t'i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE miratimin/qëndrimin përkatës të ministrisë, për zgjatjen e afatit të fillimit të punimeve/ndërtimit të hidrocentraleve “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2” përpara fillimit të operimit.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 361, datë 7.12.2023, ndryshon dhe bëhet:

2. Përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE:

a) deklaratën mjedisore të re;

b) miratimin/qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me zgjatjen e afatit të fillimit të punimeve/ndërtimit të hidrocentraleve “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k., OST sh.a. dhe FTL sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 37, datë 27.3.2024

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 81, DATË
31.5.2019, "MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË 'SGD ENERGJI' SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
'NDËRFUSHAS', ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1125 kw"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 98/7 prot., datë 25.3.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 81, datë 31.5.2019, "Mbi licencimin e shoqërisë 'SGD Energji' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali 'Ndërfushas', me kapacitet të instaluar 1125 kw",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 81, datë 31.5.2019, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "SGD Energji" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

nga HEC "Ndërfushas", me fuqi 1125 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria "SGD Energji" sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën "Për dhënien në përdorim të sipërfaqes së zonës së mbrojtur", me afat të rinovuar jo më vonë se data 14.9.2022.

3. Shoqëria "SGD Energji" sh.p.k. të depozitojë në ERE "Lejen për përdorim të burimit ujqor", me afat të rinovuar, jo më vonë se data 27.4.2022.

- Në kuadër të plotësimit të kushtit të pikës 2 të vendimit të Bordit, ERE ka kryer një korrespondencë të gjatë, me qëllim kuptimin e drejtë të çështjes dhe dokumentacionin që subjekti duhet të depozitonte në vijim për plotësimin e kësaj pike, konform kërkesave të rregullores së licencimit, por edhe dokumentacionin e duhur ligjor që ndiqet në vijim, në kuadër të së drejtës së përdorimit të pronës, duke mbajtur kështu edhe seanca dëgjimore, e në vijim ka konkluduar se subjekti në kuptim të dokumentacionit të pronësisë ka bërë regjistrimin e kontratës me MIE-n dhe është pajisur me certifikatat, kartelat dhe hartën treguese për gjithë zonën ku shtrihet projekti për një afat sa kontrata me MIE-n, cituar të detajuara në relacion.

- Për gjithë sa më sipër, referuar përcaktimeve të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të Bordit nr. 81/2019, rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacionin përkatës pronësor, që i jep të drejtën për të përdorur pronën në zonën ku shtrihet projekti, duke plotësuar kështu dhe kushtin e kësaj pike, i cili vlerësohet të shfuqizohet.

- Në kuadër të plotësimit të pikës 3 të vendimit të Bordit për depozitim të lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor, ERE me shkresat (nr. 385 prot., datë 18.3.2022, nr. 846 prot., datë 26.5.2022, nr. 846/2 prot., datë 13.9.2022, nr. 846/4 prot., datë 16.12.2022, nr. 142 prot., datë 16.1.2023) i kërkoj shoqërisë të depozitojë lejen e rinovuar, me shkresën nr. 142/1 prot., datë 9.2.2023, shoqëria depozitoi lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. serie 000081, nr. 34 prot., datë 27.12.2022, të miratuar me vendimin nr. 32, datë 14.12.2022, të Këshillit të Basenit Ujqor Mat, për përdorimin e burimit ujqor për HEC "Ndërfushas", me një afat 5-vjeçar, me afat vlefshmërie deri më deri më 13.12.2027.

- Me depozitim të këtij dokumenti, duhet të ndryshohet përmbajtja e pikës 3 të vendimit nr. 81/2019, duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit,



vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ndërfushas” brenda datës 13.12.2027, po ashtu përmbajtja e pikës 4 do të ndryshojë dhe do të bëhet: nëse subjekti nuk depoziton këtë leje brenda afatit të përcaktuar dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 81, datë 31.5.2019, të Bordit të ERE-s, shfuqizohet.

2. Pika 3 e vendimit nr. 81, datë 31.5.2019, të Bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “SGD Energji” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Ndërfushas” brenda datës 13.12.2027.”.

3. Pika 4 ndryshon dhe bëhet me përmbajtjen, si më poshtë:

“4. Në rast se shoqëria “SGD Energji” sh.p.k. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq, sikurse përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen, si më poshtë:

“5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 3.”.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë